



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1273/1 prot.

Tiranë më 29.8.2019

Lënda: Mendim mbi projektligjin "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë"

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 6750 Prot., datë 21.08.2019, projektligji "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë", në tërësi vlerësohet i hartuar konform ligjit 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Ndërkohë, duke qenë se projektligji në dispozita të caktuara të tij, rregullon trajtimin e të dhënave personale për qëllime të këtij ligji, sugjerojmë që pas pikës 32 të nenit 3, të shtohen këto përkufizime:

33. "Të dhëna personale", ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale;
34. "Përhapje", është komunikimi i informacionit për të dhënat personale palëve të papërcaktuara, në çfarëdo forme, edhe përmes vënies në dispozicion ose konsultimit;
35. "Transferim ndërkombëtar", është dhënia e të dhënave personale marrësve në shtetet e huaja.

Gjithashtu, sugjerojmë që në pikën 1, të nenit 95, togfjalëshi "...ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshohet në "... legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale", ndërsa pas pikës 4, të nenit 95, të shtohet dhe një pikë me këtë përmbajtje: "Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale, kryhet sipas përcaktimeve në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale."

Sa i përket pikës 7, të nenit 97, sugjerojmë të riformulohet nga ana juaj në rolin e kontrolluesit të të dhënave personale, duke mbajtur në vëmendje parashikimet e shkronjës d), të pikës 1 dhe pikën 2 të nenit 5 si dhe pikën 4, të nenit 27 të ligjit nr.9887/2008, i ndryshuar. Një propozim i tillë vjen pasi ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nuk ka një afat konkret për kohën e mbajtjes së të dhënave personale, por është kontrolluesi

përgjegjës për zbatimin e rregullave për përcaktimin e kësaj kohe sipas qëllimit për të cilin të dhënat janë grumbulluar.

Në rast se nga ana e kontrolluesit është e pamundur të përcaktohet një afat specifik për shkatërrimin ose asgjësimin e të dhënave personale, sugjerojmë që pika 7, e nenit 97 të riformulohet si vijon:

*"7. Të dhënat personale të mbledhura për qëllime të këtij ligji, asgjësohen ose shkatërrohen pas përmbushjes së qëllimit të grumbullimit, sipas parimeve të përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale."*

Gjithashtu, mbështetur në nenin 18, të ligjit nr.9887/2008, i ndryshuar, propozojmë, që në nenin 97, të projektligjit, të shtohet dhe një pikë me këtë përmbajtje: *"8. Institucionet ligj zbatuese duhet të informojnë subjektin e të dhënave për të gjithë procesin e përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të detyrimeve ligjore."*

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

